




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 544 /18

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Blerim Dina – Kryetar, z. Nuhi Paçarizi. - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “RSM Company”- Prishtinë kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku për kontratë është rekomanduar OE-“R&Rukolli”-Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull prokurimit: “Rrethrotullimi Lakrishtë – Rrethrotullimi Arbëri” me numër të prokurimit : 616-18-3326-512, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) “KK-Prishtinë”, më datën 01.11.2018 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Rsm Company”- Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rrethrotullimi Lakrishtë – Rrethrotullimi Arbëri” me numër të prokurimit : 616-18-3326-512, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues AK - “KK-Prishtinë”.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës i AK -së “KK-Prishtinë”, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Rrethrotullimi Lakrishtë – Rrethrotullimi Arbëri” me numër të prokurimit : 616-18-3326-512, dhe lënda kthehet në Ri vlerësim.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Rsm Company”- Prishtinë aprovet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 14.05.2018

Hapja e ofertave është bërë me dt: 04.06.2018

Data e njoftimit me letër standarde: 24.09.2018

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik “Rsm Company”- Prishtinë me dt: 27.09.2018, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Autoriteti Kontraktues me datën 28.09.2018 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e OE: “Rsm Company”- Prishtinë si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues “Rsm Company”- Prishtinë si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 05.10.2018 me nr. 544/ 18, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rrethrotullimi Lakrishtë – Rrethrotullimi Arbëri” me numër të prokurimit : 616-18-3326-512, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) “KK-Prishtinë”, duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1,6,7,59,60,61 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 10.10.2018 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues profesional në raportin e dt: 22.10.2018, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues “Rsm Company”- Prishtinë në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të këtij aktiviteti të prokurimit, konstaton si në vijim:

Eksperti shqyrtues, sqaron se AK-ja, pas hapjes së ofertave ka krijuar komisionin për vlerësimin e ofertave, të cilët gjatë vlerësimit të ofertave kanë kërkuar sqarim nga OE “Rsm Company” sqarim në lidhje me disa pozicione dhe pas analizës së bërë nga komisioni i njëjti është bindur dhe e kanë rekomanduar për kontratë OE

ankues "Rsm Company".

Siç është sqaruar edhe me larte menaxheri i prokurimit nuk është bindur me rekomandimin e komisionit vlerësues, te cilin nuk e aprovon dhe njëherit nxjerr vendim me shkrim ku e arsyeton refuzimin e rekomandimit te komisionit vlerësues. Ne vendimin e datës : 18.09.2018, menaxheri i prokurimit, ne arsyetimin e dhëne deklaroi se oferta e OE "Rsm Company" duhet te konsiderohet si ofertë me çmim Jo-Normalisht te ulet, për pozicionet nr: 2.1, 2.3, 1.1.1, 1.2, 1.3, nga gjithsej (9) nëntë pozicione sa janë kërkuar sqarime nga OE "Rsm Company".

Për pozicionet e lartpërmendura OE "Rsm Company", ka dhëne këto çmime:

Pozicioni 2.1 - Germimi i dheut te kat. se III-te dhe te IV-te: 0.80 euro/cent.

Pozicioni 2.3 - Furnizimi, trans. dhe shtrirja e gjeotekstilit: 0.80 euro/cent.

Pozicioni 1.1.1 - Germimi i kanalit te gjate 767.5m: 0.70 euro/cent.

Pozicioni 1.2 - Germimi me makine: 1.00 euro.

Pozicioni 1.3 - Germimi me dore: 1.00 euro.

Përfundimisht menaxheri i prokurimit, për çmimet e dhëna ne pozicionet e lartpërmendura i ka arsyetuar, duke ju referuar qmimorës se KRPP-se, ku ka deklaruar se për pozicionin nr: 2.1 çmimi do te duhej te ishte rreth 4.00 euro, për pozicionin nr: 1.2 çmimi do te duhej te ishte 3.43 deri ne 4.26 euro, po ashtu ne pozicionin nr: 1.3 do te duhej te ishte 3.83 deri ne 4.36 euro sipas qmimorese referente te KRPP-së.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues, konform kërkesës se AK-së, për sqarim te pozicioneve, ka kthyer përgjigje duke i arsyetuar çmimet e dhëna ne ofertën e tij financiare për te cilat edhe i ka bashkangjitur disa fatura si sqarim për AK-ne, se ne si operator ekonomik do ta realizojmë projektin ne fjale dhe krejt ne fund është zotuar nen betim se do te realizohet ky projekt nga ana jone dhe se qëndrojmë prapa ofertës tone financiare.

Ne vazhdim eksperti shqyrtues, sqaron se pretendimi i OE ankues ne lidhje me rregullat për çmime Jo/Normalisht te ulëta është pjesërisht i qëndrueshëm për faktin se oferta financiare e OE ankues sipas përlllogaritjes nuk rezulton te jetë apo ta ketë plotësuar kushtin për tu kualifikuar si ofertë me çmim Jo/Normalisht e ulet. Mirëpo në nenin 4 të Rregullores për çmime Jo/Normalisht te ulëta, thuhet se kur një tender konsiderohet si jo-normalisht i ulet, nuk mund të refuzohet pa hetimin dhe shqyrtimin e elementeve të rëndësishme (procedura *Inter Partes*), të cilët e ka bërë AK-ja, dhe në rastin konkret komisioni vlerësues është bindur ndërsa menaxheri nuk është bindur.

Eksperti shqyrtues, sqaron se sipas paragrafit 4 të nenit 61 të LPP-së, vlerësimi i ofertës financiare është e drejte e autoritetit kontraktues, e cila pas marrjes se informacioneve nga tenderuesi dhe sqarimeve të dhëna autoriteti kontraktues, konkretisht menaxheri i prokurimit ka vendosur se tenderi është jo-normalisht i ulët, dhe të njëjtin sipas paragrafit 4 të nenit 61 të LPP-së, autoriteti kontraktues e ka refuzuar.

Gjithashtu eksperti shqyrtues, sqaron se sipas nenit 40.13 të Rregullores dhe Udhëzuesit për Prokurim Publik, vendimmarrja përfundimtare për një aktivitet të prokurimit i takon menaxherit të prokurimit. Prandaj është i paqëndrueshëm ky pretendim i OE ankues. Citat neni 40.13: Vendimi përfundimtar mbi dhënien e kontratës mbetet përgjegjësi e Zyrtarit përgjegjës të Prokurimit. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mund të pranojë rekomandimin e komisionit apo refuzojë atë. Kur refuzohet rekomandimi i komisionit, Zyrtari përgjegjës Prokurimit do të shpjegojë arsyet me shkrim. Në situata të tilla Zyrtari përgjegjës i Prokurimit mund të nxjerr vendimin përfundimtar ose mund të formoj komision të ri për ri-vlerësim. Shpjegim i tillë do të përfshihet në procesverbalin e aktivitetit të prokurimit. ZKA i AK-së menjëherë do të informohet për këtë refuzim. Informacioni duhet të jepet me shkrim.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, ndërsa vendimi për dhënie të kontratës të mbetet në fuqi.

Operatori Ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të datës: 23.10.2018 ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 23.10.2018, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 01.11.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtuesi, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, operatori ekonomik ankues, ku shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues z.Kamberi deklaroj: Ne si palë ankuese qëndrojmë pranë gjitha pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesë. Dua të lidhem me ekspertizën, ku z. Basha në raportin e tij ka bërë vetëm një kronologji të aktivitetit të prokurimit dhe nuk ka bërë shqyrtim të ankesës tonë sipas LPP-së ai obligohet të bëjë shqyrtimin e pikave ankimore dhe provave të paraqitura në ankesë të cilën nuk e ka bërë.

Madje në pretendimin tonë që AK për qëllim dëmtimin e buxhetit të Kosovës, eksperti nuk ka dhënë asnjë mendim kur dihet që me vendimin e AK-së, buxheti i Kosovës dëmtohet prej 38,198€. AK-komuna e Prishtinës gjatë vlerësimit – z. Bardhaj, nuk ka marr parasysh pikën 4.4 të rregullave për tender jo normalisht të ulët të shpallur nga KP ku thotë “gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulët AK duhet të merr në konsideratë pika 4.4.2 thotë “çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur dhe pika 4.4.3 thotë “çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punës, dhe ose ushtrimin e aktivisteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar”, madje zyrtari kryesor i prokurimit z. Bardhaj dëshmitë që i kemi paraqitur me rastin e sqarimit që ka kërkuar AK i ka quajtur marrëveshje fiktive, marrëveshjet që kemi pas për furnizim me kompaninë Mineral LLC dhe Bau Market. Si dëshmi i ofroj panelit ofertat origjinale nga kompania Mineral LLC dhe Bau Market si dhe deklaratat e tyre se qëndrojnë prapa këtyre ofertave për këtë projekt. Vlen të ceket që AK ka kërkuar sqarim edhe nga kompani tjera dhe në këtë rast sqarimet e kompanive tjera i ka pranuar. Kurse sqarimin tonë e ka refuzuar e ka hedh poshtë. Pra me këtë veprim AK nuk ka respektuar nenin 59 të LPP-së si dhe nenin 7 të LPP-së pasi që nuk i ka trajtuar njëjtë gjithë ofertuesit, përkitazi me rregulloren për çmime jo normalisht të ulëta, një gjë tjetër që duhet cekur se ne kemi tenderuar në KK Prishtinë në tenderin Asfaltimi rrugës Matiqan-Butoc që edhe ku tender ka qenë me para kualifikim ku edhe për këtë është kërkuar sqarim i çmimit, ku si përgjigje kemi dërguar sqarimin po thuajse identik dhe në këtë rast AK e ka pranuar si të mirëfilltë. Kurse për tenderin që jemi ankimuar AK nuk e ka pranuar si valid. Kjo tregon se AK përdor standarde të dyfishta për të njëjtat çështje kur i konvenon. Kemi dëshmi kërkesën e AK-së për sqarim të çmimeve, përgjigjen tonë të dorëzuar dhe letrën standarde për tenderues të pasuksesshëm ku nuk jemi shpërblyer me kontratë për arsye të çmimit të lartë. PO ashtu para nënshkrimit të një kontrate me AK çdo here kërkohet të paraqitet siguri ekzekutimit në vlerë së parku 10% e ku AK ka drejt të kërkojë vlerë edhe më të madhe. Në rast dëshmimit të realizimit të kontratës ai siguri konfiskohet nga ana e AK-së. Zyrtari kryesor i prokurimit pranë AK z.Bardhaj në vendimin e tij për hedhje poshtë të raportit të komisionit të rivlerësimit (sepse dy here komisioni i vlerësimit ka rekomanduar për kontratë OE:”RS”), z. Bardhaj është bazuar në çmimet referente të publikuara në faqe të KRPP të cilat çmime nuk kanë limit poshtë ose lart dhe në rast se edhe projektimet e tenderëve do bëheshin në këtë çmimore referente atëherë vlera parashikuar një kontrate do ishte 3 deri katër here më e madhe se që është KK Prishtinë z.Bardhaj si zyrtar kryesor, që thirret në çmimet referente tenderin në vlerë të parashikuar 980.000€ me titull Ndërtimi i rrugës Richard Helbrook e ka nënshkruar me kompaninë ToiFor me vlerë 470,000€ ose me përqindje 53% më e ulët se vlera e parashikuar nga AK. Dëshmi njoftimi për dhënie të kontratës. Në këtë rast AK nuk i pranon as ofertat

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së znj. Dalipi deklaroj: Pajtohem me raportin e ekspertizës së ekspertit dhe i propozojmë panelit të refuzoj ankesën e OE ankues të pabazuar.

Gjatë prezantimit në seancë ekspertit shqyrtues z. Basha deklaroj: Në këtë aktivitet të prokurimit OE ankues ka dorëzuar ofertën me çmim më të lirë, për të cilën komisioni gjatë vlerësimit i ka kërkuar sqarime dhe i njëjti sipas kërkesës së AK i ka dorëzuar edhe dëshmitë lidhur me çmimet të cilat AK i konteston. Sa i përket rregullores për çmime jo normalisht të ulëta, çmimi i OE ankues nuk plotëson kushtin për tu kualifikuar si ofertë me çmim jo normalisht të ulët. Vlen të ceket se komisioni pas pranimit të përgjigjeve të dhëna nga OE ankues është bindur dhe të njëjtin e kanë rekomanduar për kontratë. Me këtë rekomandim të komisionit nuk është pajtuar menaxheri i cili e ka anuluar vlerësimin e komisionit dhe e ka eliminuar të njëjtin si ofertë me çmim jo normalisht të ulët. Andaj sipas par.4 neni 61 vlerësimi i çmimeve është e drejtë e AK-së. Andaj qëndroj pranë raportit të ekspertizës dhe rekomandimit të dhënë në ekspertizë.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i OE z. Kamberi deklaroj: I ofroj paneli po ashtu si provë një vendim të OSHP-së me nr.211/18 ku për rast të ngjashëm për shkak çmimeve OSHP ka vendos në favor të OE ankues. I propozojmë panelit të aprovoj ankesën tonë si të bazuar dhe lënda të kthehet në Rivlerësim

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i AK z.Sylejmani deklaroj: I propozojmë panelit të vërtetoj si të bazuar vendimin e AK-së .

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim, sqaron se AK-ja, pas hapjes së ofertave ka krijuar komisionin për vlerësimin e ofertave, të cilët gjatë vlerësimit të ofertave kanë kërkuar sqarim nga OE “Rsm Company” sqarim në lidhje me disa pozicione dhe pas analizës së bërë nga komisioni i njëjti është bindur dhe e kanë rekomanduar për kontratë OE ankues “Rsm Com, por me këtë vlerësim nuk është bindur Menagjeri i prokurimit dhe se i njëjti ka rekomanduar për kontratë OE-“R&Rukolli”-Prishtinë .

Paneli shqyrtues sqaron nga ana autoriteti kontraktues nuk është zbatuar neni 3 i Rregullat për çmime Jo/Normalisht të ulëta sipas tabelës së dhënë në këtë rregullore, prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ndjek procedurat siç parashihen tek rregullorja për tender jo normalisht të ulët dhe nëse plotësohet tri kushtet e kësaj tablele AK-ja, të vazhdoj me procedurat e nenit 4 të Rregullores për çmim jo normalisht të ulët.

Paneli shqyrtues sqaron se OE ankues në seancën për shqyrtim kryesor ka prezantuar dëshmitë të cilat AK-ja, i ka quajtur marrëveshje fiktive, marrëveshjet që OE ankues ka pas për furnizim me kompaninë Mineral LLC

dhe Bau Market, ku si dëshmi i kanë ofruar panelit ofertat origjinale nga kompania Mineral LLC dhe Bau Market si dhe deklaratat e tyre se qëndrojnë prapa këtyre ofertave për këtë projekt. Paneli shqyrtues konstaton se AK-ja me rastin e rivlerësimit duhet të ketë parasysh dëshmitë e cekura si më lart dhe se trajtimi i ofertave të OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit të behet në pajtim me nenin 7 të LPP-së si dhe vlerësimi ,krahasimi dhe ekzaminimi i ofertave të behet në pajtim me nenin 59 të LPP-së.

Sa i përket pretendimit të ankuesit se AK KK Prishtinë në tenderin “Asfaltimi rrugës Matiqan-Butofc”, ku ky tender ka qenë me para kualifikim ku edhe për këtë është kërkuar sqarim i çmimit, ku si përgjigje OE ankues i ka dërguar sqarimin po thuajse identik, me rastin për të cilin tani ankuesi ka parashtruar ankese, dhe se në rastin e “Asfaltimi rrugës Matiqan-Butofc”, AK-ja sqarimet e dhëna nga ankuesit i e ka pranuar si të mirëfilltë, ndërsa sqarimet e dhëna në aktivitetin e prokurimit “Rrethrotullimi Lakrishtë – Rrethrotullimi Arbëri” me numër të prokurimit : 616-18-3326-512”, nuk janë bindëse për AK-në, Paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues nuk mund të aplikoj standarde të dyfishta për objekt shqyrtimi të njëjta apo për raste të njëjta duke e diskriminuar apo favorizuar ndonjë operator ekonomik të caktuar në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk ka zbatuar nenin 1,6,7,59,60 të LPP-së si dhe nenin 3 të Rregullat për tender jo normalisht të ulet, andaj me rastin e rivlerësimit AK-ja, është e obliguar që të zbatoj dispozitat e cekura si më lart dhe se, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të behet në bazë të kërkesave të vendosura në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – “KK-Prishtinë”,
- 1x1 OE- “RSM Company”- Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.

